

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në Spanjë mund të blini një fshat për 850,000 euro... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/ne-spanje-mund-te-blini-nje-fshat-per-850000-euro/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:30:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:10:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	066ec5e5cb9a9d09fb14ebe635608dd1a569efd5e41fe24244e7351480e0ac64
TEKSTI	d1980b2538c177a061f1b183f26e1ba5a10ef299b224a8fe6c8d62061509e61e
PAMJA	3964d72e2a9e05c6995a37106201cac469efc9ec96d140a768df140d05efff6c6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4daaefb5b3bd105dbd285b9a42622e7a7e3bf961337d8abb8879568566102464
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4daaefb5b3bd105dbd285b9a42622e7a7e3bf961337d8abb8879568566102464>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Lifestyle

Në Spanjë mund të blini një fshat për 850,000 euro...



Marisa Karabeci

26 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Në një përpjekje për t'u dhënë jetë të re fshatrave të vegjël që përballen me një krizë të rëndë demografike, si dhe për të restauruar ndërtesat që kanë pësuar dëme me kalimin e kohës, bashkitë në Itali po ofrojnë shtëpi për vetëm 1 euro. Në realitet, sigurisht, kostoja reale është dukshëm më e lartë, pasi shuma të mëdha duhen shpenzuar për rinovimin e pronave, të cilat në disa raste janë pothuajse në rrënoja.

Por, disa kilometra larg, në Spanjën veriore, nuk është në shitje një shtëpi e vetme, por një fshat i tërë. Sipërfaqja prej 16.1 hektarësh në provincën e Ourense në Galicia, në një zonë të njohur për peizazhet e saj të gjelbërta, ujin kristalor që rrjedh në lumenj dhe shtëpitë historike prej guri, një vendbanim në komunën e Viana do Bolo, me ndërtesa me një sipërfaqe totale prej 2,000 metrash katrorë, pret një blerës.

Fshati ka 11 shtëpi, me gjithsej 40 dhoma gjumi dhe më shumë se 20 banjo, ndërsa shtëpia më e madhe ka 2 kate dhe një sipërfaqe totale prej 668 metrash katrorë, saqë mbulon pothuajse një të tretën e sipërfaqes totale. Sigurisht, nga këto, vetëm tre karakterizohen si në "gjendje të shkëlqyer", disa mund të banojnë menjëherë dhe pjesa tjetër ka nevojë për rinovim. "Paketa" përfshin gjithashtu një faltore tradicionale, një dyqan, një zyrë mjekësore dhe dy depo. Të gjitha këto në një vend, siç thuhet në reklamë, me akses të mirë rrugor dhe në afërsi të qyteteve, shërbimeve bazë dhe zonave pyjore.

Vendndodhja e qetë, e kombinuar me madhësinë e zonës, i ka shtyrë agjentët e pasurive të paluajtshme ta promovojnë atë si një strehë të mundshme turistike me ndërtimin e hoteleve butike. Kostoja e fshatit është 850,000 euro, një çmim që është ulur ndjeshëm pasi deri vonë ishte nxjerrë në shitje për 1.5 milion euro. Sipas agjencisë së pasurive të paluajtshme Asturian Property, kompleksi i vetëm i ndërtesave u ndërtua për të strehuar punëtorët që morën pjesë në krijimin e tre digave hidroelektrike në zonën përreth.

Njëra prej tyre, As Portas, ishte veçanërisht e rëndësishme. Puna e saj filloi në vitet 1960 dhe

përfundoi në vitin 1974, duke punësuar rreth 4,000 njerëz. Me një kapacitet prej gati 536 milionë metrash kub ujë, është rezervuari i dytë më i madh artificial në Galicia, ndërsa lartësia e digës arrin 140 metra, duke e bërë atë më të lartën në të gjithë Galician dhe të katërtin më të lartë në të gjithë Spanjën.

Kur projekti përfundoi, fshati nuk kishte arsye të ekzistonte, kështu që punëtorët u zhvendosën në zona të tjera. Nuk u bë një fshat i rregullt, ndoshta sepse nuk kishte një popullsi të mjaftueshme të përhershme dhe zona më e gjerë ishte tashmë në një proces të shpopullimit intensiv rural. Edhe pse komuna e Viana da Bolo kishte pothuajse 8,500 banorë në vitet 1950, sot ajo ka vetëm 2,700.

Fenomeni i migrimit të brendshëm ka formësuar hartën demografike të Spanjës për dekada të tëra. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë po largohet nga zonat rurale dhe të largëta dhe po zhvendoset drejt qendrave urbane, duke çuar në tkurrjen e shumë fshatrave. Ndërsa të rinjtë zgjedhin qytetet për të kërkuar punë, shumë komunitete tradicionale po zbrazen gradualisht, duke lënë pas ndërtesa që kanë nevojë për pronarë të rinj.

Fshati në Ourense nuk është një shembull i izoluar në Spanjë. Vitet e fundit, vendbanimet e braktisura janë shfrytëzuar me qëllim krijimin e akomodimeve turistike. Midis tyre, Salto de Castro në provincën e Zamorës, pranë kufirit me Portugalinë, i cili u braktis në vitin 1989, kur familja e fundit që jetonte atje u largua, dhe në vitin 2025 u ble nga një investitor amerikan.

Edhe në këtë rast, vendbanimi ishte krijuar për të strehuar punëtorët e përfshirë në ndërtimin e një projekti hidroelektrik. Jason Lee Beckwith, një muzikant që drejtonte një hotel me mëngjes dhe një shtypshkronjë në Kaliforni, bleu fshatin për 310,000 euro. Ai thotë se u dashurua me shikim të parë me fshatin, i cili ka një kishë, një shkollë, një restorant dhe disa shtëpi.

LAJME TË NGJASHME



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete “Made in China”!
2 MIN



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!
2 MIN



Volkswagen vjen me një shërbim të ri, ja se çfarë duhet të dini!
1 MIN



A mund ta përkeqësojë teshtima hernien diskale? Ja çfarë duhet të dini!
2.5 MIN



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?
3.5 MIN

MË TË LEXUARAT



“Nië nollitikan. vaiza e Alfred



Rama në Këshillin Eurobian të



Ovtetarët no naralaimehohen të



E reia vien me nië nioftim



Nations League. Kosova debuton

Cakos dhe..."/ Bledi Mane
zbulon banorët e këtij sezoni të
BBV?

Korporatave: Paqja, kusht për
zhvillimin ekonomik!

qëndrojnë larg një dashi të
rrezikshëm që endet i lirë në
qytet!

interesant: "Kërkoj një burrë me
mbiemrin tim..."

me fitore!



Italia ndalon burkën në
shkolla/Kufizime edhe për
nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të
digjet nga dashuria këtë
fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve
secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku
ngjalën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë
para se të dëgjoni muzikë me zë
të lartë, do të gjobiteni!


EDITORI SUGJERON



Sa kalori digjen gjatë vërtetë
seksit?!



"Zemra ndalet për gjysmë
ore..."/ Prof. Dr. Altin Veshti
zbulon çfarë ndodh gjatë
operacionit: Pacientët kanë frikë!



Melatonina apo L-Theanine?! Ja
cili suplement mund të ndihmojë
më shumë me gjumin...



Të njëjtat vargje të përsëriten
gjithë ditën? Ja pse një këngë
mund të të "ngecë" në kokë...



Një ilaç i ri për kancerin e
pankreasit mund t'u japë
pacientëve më shumë kohë!




"Një politikan, vajza e Alfred
Cakos dhe..."/ Bledi Mane
zbulon banorët e këtij sezoni të
BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At
Nikolla Xhufka tregon si vepron
kur përballlet me tundimet
seksuale: Edhe tani me vajza të
bukura...



"Më bezdis përndjekja..."/Ina
Aderi: Më kanë ngacmuar
personazhe, do dashurohem larg
kamerave...



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në
Nations League, të gjitha
emocionet live dhe ekskluzivisht
në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

Email:

Tel: +355 69 208 0500

+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktimi](#)

[Marketing](#)

[Frekuencat](#)

[Aksesueshmëria](#)

[Mundësi Punësimi](#)

[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.